



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO  
KOMUNA E GJAKOVËS  
OPŠTINA DJAKOVICA/MUNICIPALITY OF GJAKOVA

**Kryetarja e Komunës**

**01nr \_\_\_\_\_**

**Dt: 04.11.2015**

Kryetarja e Komunës së Gjakovës, në bazë të nenit 13 dhe 58 shkronja a dhe b të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr.03/L-040, nenit 8,9,10 dhe 14.a të Rregullores për Ndryshimin dhe Plotësimin e Rregullores për Ndarjen e Subvencioneve Komunale, Përfundimit 01 nr. 06-75711-18/2 i dt. 23.10.2015 më të cilin është aprovuar kërkesa e Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport për mbulimin e shpenzimeve të Klubit Hendbollistik të meshkujve “Vëllaznimi”, me dt: 04.11.2015 e miraton këtë:

**V E N D I M**

1. Miratohet kërkesa e Klubit Hendbollistik të meshkujve “Vëllaznimi” nga Gjakova nr. 10-400-75819 e dt: 23.10.2015, për mbulimin e shpenzimeve të pjesës së mbetur të kampionatit, duke e mbështetur këtë kërkesë me subvencione komunale të Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport në vlerë prej 1,000.00€.

2. Autorizohet Drejtoria për Buxhet dhe Financa që të realizon procedurën e zotimit të mjeteve financiare në vlerë prej 1,000.00€, nga mjetet e fondit të subvencioneve të Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport dhe bartjen e tyre në konton e Klubit Hendbollistik të meshkujve “Vëllaznimi” nga Gjakova nr.1402000001751658 Banka Ekonomike

3. Ky vendim hynë në fuqi menjëherë.

**CO:** - Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport

- Drejtorisë për Buxhet dhe Financa

- Z. Brendon Nikoliqi, kryetar i KH “Vëllaznimi”, Gjakovë

- Arkivit

**Kryetarja e Komunës,**

**Znj. Mimoza Kusari- Lila**